



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 12/08/2021 Ref.: 3021/21

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 87-të, të mbajtur më 07 dhe 27 Korrik 2021, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditoohen programet e studimit të Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
 - Pedagogji e Përgjithshme, BA, 180 ECTS, maksimumi 40 studentë për vit akademik.
 - Edukimi Fillor, BA, 240 ECTS, maksimumi 70 studentë për vit akademik.
 - Master i Mësimdhënies Lëndore (me specializim në: Mësimdhënia e Matematikës, Mësimdhënia e Fizikës, Mësimdhënia e Kimisë, Mësimdhënia e Biologjisë, Mësimdhënia e Historisë, Mësimdhënia e Gjeografisë, Mësimdhënia e Teknologjisë dhe TIK-ut, Mësimdhënia e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, MA, 120 ECTS), maksimumi 320 studentë për vit akademik (nga 40 studentë në secilin specializim).
- II. Akreditoohen programet e studimit të Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
 - Edukimi në Fëmijërinë e Hershme, BA, 240 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik.
 - Master në Shkenca të Edukimit (me specializim në: Këshillim Pedagogjik, Edukim Inklusiv, Udhëheqja në Arsim, Mësimdhënia dhe Kurrikula), MA, 120 ECTS, maksimumi 160 studentë për vit akademik (nga 40 studentë në secilin specializim).
- III. Nuk akreditohet programet e studimit të Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”,

- Master në Pedagogji për Shkolla Profesionale, MA, 120 ECTS.

IV. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.

V. Obligohet Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri më datë 15.11.2021 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.

VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

I. Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1	Pedagogji e Përgjithshme, BA, 180 ECTS Ri-akreditim	Vlora Sylaj Minevere Rashiti Edona Berisha Kida
2	Edukimi Fillor, BA, 240 ECTS Ri-akreditim	Hatixhe Ismajli Vjollca Ahmedi Myrvete Dreshaj Teuta Danuza Fahri Marevci
3	Master i Mësimdhënies Lëndore (me specializim në: Mësimdhënia e Matematikës, Mësimdhënia e Fizikës, Mësimdhënia e Kimisë, Mësimdhënia e Biologjisë, Mësimdhënia e Historisë, Mësimdhënia e Gjeografisë, Mësimdhënia e Teknologjisë dhe TIK-ut, Mësimdhënia e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, MA, 120 ECTS) Ri-akreditim	Ganimete Kulinxha Eda Vula Zeqir Veselaj Arlinda Bytyqi Damoni Bahtije Gërbeshi Zylfiu Zeqir Shaqiri Kyvete Shatri Begzad Baliu Sedat Baraliu Naser Pajaziti
4	Edukimi në Fëmijërinë e Hershme, BA, 240 ECTS Akreditim	Rozafa Ferizi Shala Blerta Perolli Shehu Adhurim Rasimi Adelina Hajrullahu Xhavit Beqiri
5	Master në Shkenca të Edukimit (me specializim në: Këshillim Pedagogjik, Edukim Inkluziv, Udhëheqja në Arsim, Mësimdhënia dhe Kurrikula), MA, 120 ECTS Akreditim	Naser Zabeli Majlinda Gjellaj Albulena Metaj Macula Ardita Devolli Arlinda Beka
6	Master në Pedagogji për Shkolla Profesionale, MA, 120 ECTS Akreditim	Blerim Saqipi Kastriot Buza

Çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, duhet të raportohet dhe arsyetohet në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar duhet të aprovohet nga KSHC.

AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Edukimit Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Vizita është organizuar më 26.03.2021, me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Josip Burušić, Delia Gologan, Melita Kovačević dhe Elene Jibladze.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit, dhe për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit Pedagogji e Përgjithshme, BA, 180 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht pesë (5), pjesërisht dy (2).
2. Për programin e studimit Edukimi Fillor, BA, 240 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht pesë (5), pjesërisht dy (2).
3. Për programin e studimit Master i Mësimdhënies Lëndore (me specializim në: Mësimdhënia e Matematikës, Mësimdhënia e Fizikës, Mësimdhënia e Kimisë, Mësimdhënia e Biologjisë, Mësimdhënia e Historisë, Mësimdhënia e Gjeografisë, Mësimdhënia e Teknologjisë dhe TIK-ut, Mësimdhënia e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, MA, 120 ECTS), nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht pesë (5), pjesërisht një (1).
4. Për programin e studimit Edukimi në Fëmijërinë e Hershme, BA, 240 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht katër (4), pjesërisht tri (3).
5. Për programin e studimit Master në Shkenca të Edukimit (me specializim në: Këshillim Pedagogjik, Edukim Inkluziv, Udhëheqja në Arsim, Mësimdhënia dhe Kurrikula), MA, 120 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht katër (4), pjesërisht dy (2).
6. Për programin e studimit Master në Pedagogji për Shkolla Profesionale, MA, 120 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht një (1), pjesërisht gjashtë (6).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 87 të mbajtur më 07. 07. 2021 dhe 27.07.2021 ka shqyrtuar aplikacionin e Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

AKA - Agjencia e Kosovës për Akreditim

- Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakultetit të Edukimit;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.




Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë